



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE KUALIFIKIMEVE

PROCESI I VETËVLERËSIMIT TË OFRUESVE PUBLIKË TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL

RAPORT KOMBËTAR PËR PROCESIN DHE REZULTATET

**PERIUDHA E VETËVLERËSIMIT
2022-2023**

SHKURTIMET

AFP	Arsim dhe Formim Profesional
IoAFP	Institucion ofrues i Arsimit dhe Formimit Profesional
SD4E	Programi i Zhvillimit të Aftësive për Punësim
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
ETF	Fondacioni Evropian e Trajnimeve
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MEKI	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
AKAFP	Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
IoAFP	Institucione ofruese të arsimit dhe formimit profesional
QFP	Qendër e Formimit Profesional
Qa	Sigurimi i Cilësisë
SKPA	Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
KSHK	Korniza Shqiptare e Kualifikimeve
NJZH	Njësia e Zhvillimit
OJF	Organizata jofitimprurëse
PEI	Plane Edukative Individuale

PËRMBLEDHJE

Mbështetur në Udhëzimin nr. 18, datë 6.7.2021, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “*Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 16, datë 8.5.2018, “Për zhvillimin e vetëvlerësimit në institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional”*”, ofruesit publikë të AFP-së kanë zbatuar si çdo vit procesin e vetëvlerësimit sipas kalendarit të hartuar nga AKAFPK, kanë mbledhur të dhënat dhe kanë hartuar raportin përfundimtar të vetëvlerësimit.

Në përfundim të procesit të vetëvlerësimit për vitin shkollor 2022-2023, u mbledhën të gjitha raportet e dërguara nga ofruesit e AFP-së. Raportet janë analizuar nga sektori i akreditimit të ofruesve të AFP-së gjatë periudhës shkurt - mars 2024 për të përgatitur raportin përmbledhës për rezultatet e vetëvlerësimit në nivel kombëtar.

Në këtë raport është prezantuar kuadri historik dhe kuadri rregullator për sigurimin e cilësisë në sistemin e arsimit dhe formimit profesional në Shqipëri, me institucionet shtetërore të përfshira dhe përgjegjësitë e tyre.

Pasi është prezantuar instrumenti, metodologjia e vetëvlerësimit si dhe kalendarit i zbatimit të procesit të vetëvlerësimit për vitin shkollor 2022-2023, janë prezantuar rezultatet e ofruesve të AFP-së për të pesë fushat e cilësisë. Në këtë raport është paraqitur analiza cilësore dhe analiza sasiore e të dhënave të mbledhura nga raportet e vetëvlerësimit si dhe nga platforma *scvet.al*.

Pasi janë identifikuar çështjet që kanë nevojë për përmirësim, janë formuluar rekomandimet përkatëse sipas nënfushave, si dhe çështjet që do të merren në konsideratë nga AKAFPK për të përmirësuar më tej këtë proces.

KONTEKSTI HISTORIK

Sistemi i AFP-së në Shqipëri është një sistem kryesisht me bazë shkollën dhe Qendrat e Formimit Profesional. Në sistemin e AFP-së, AKAFPK ka zhvilluar një cikël koherent politikash të proceseve të brendshme për zhvillimin dhe ruajtjen e kualifikimeve profesionale i cili mbështet rëndësinë e kualifikimeve për tregun e punës. Në sfondin e politikave, prej disa vitesh janë bërë përpjekje të shumta për ta zhvendosur fokusin drejt AFP-së dhe rezultatet kanë qenë të dukshme, ndër të cilat mund të përmendim aktivizimin për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe kuadrit të kualifikimeve profesionale, përmirësimin e procesit të të nxënimit duke e vënë theksin te rëndësia e të nxënimit me bazë punën, rritjen e ndjekjes së shkollave profesionale, promovimin e AFP-së përmes aktiviteteve promociionale dhe konkurruese etj. Një përpjekje që ka dhënë rezultate pozitive është gjithashtu pjesëmarrja e biznesit në bordet e shkollave, me synim rritjen e kontributit të sektorit jopublik dhe pjesëmarrjen më aktive dhe më efikase të tij në AFP, duke plotësuar hendekun që ekziston mes arsimit profesional dhe tregut të punës, si dhe duke rritur cilësinë.

Projekti SD4E, në bashkëpunim të ngushtë me AKAFPK dhe grupe të tjera interesi, punoi për të përcaktuar tiparet e dëshiruara dhe fizibilitetin e sistemit të sigurimit të cilësisë. Tashmë viti shkollor 2022-2023 ishte viti i gjashtë i zbatimit të procesit të vetëvlerësimit, i cili dëshmon për një rritje të ndërgjegjësimit të ofruesve të AFP-së për rolin e procesit të vetëvlerësimit në sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë. Kriteret dhe standardet minimale të pranuar, pjesë e instrumentit të vetëvlerësimit, janë zbatuar edhe këtë vit nga të gjithë ofruesit publikë të AFP-së në Shqipëri. Këto standarde dhe kriteret përbëjnë bazën e modelit të sigurimit të cilësisë dhe akreditimit në AFP drejt modernizimit të kontekstit të arsimit profesional dhe garancisë që të diplomuarit e AFP-së të kenë njohuritë dhe kualifikimet për t'iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës.

Programi “Zhvillimi i Aftësive për Punësim 2023 - 2027”, i financuar nga qeveria zvicerane dhe i zbatuar nga UNDP, vijon mbështetjen për Ministrinë përgjegjëse për AFP, dy agjencitë zbatuese, si dhe aktorë të tjerë në zbatimin e një procesi kompleks të optimizimit të ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional, bazuar në një qasje bashkëpunuese e gjithëpërfshirëse. Procesi i optimizimit ka nisur në vitin 2014, me një studim fillestar të rrjetit të ofruesve të AFP-së, studim i realizuar nga GIZ dhe ETF. Në vijim të këtij studimi, në vitin 2015 UNDP prezantoi një dokument për reformimin e sistemit, i ndjekur nga një plan i hartuar nga asistencë teknike e Bashkimit Europian (BE) në kuadër të IPA 2013 në 2017, si dhe një studim fizibiliteti dhe plan investimesh nga KfW në 2019. Mbi këtë bazë, MFE, me mbështetjen e projektit SD4E, realizoi një analizë shumëdimensionale të kontekstit social-ekonomik dhe tregut të punës, kombinuar me një vlerësim të plotë të të gjithë ofruesve publikë të AFP-së për eficiencën dhe efikasitetin e tyre. Bazuar në informacionet nga të dy këto studime, u hartua plani i optimizimit të ofruesve të AFP-së, i cili u miratua nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë në qershor 2022. Në të njëjtën kohë me përpjekjet për optimizimin, vitet e fundit me mbështetjen e projektit SD4E, institucionet përgjegjëse (MFE, AKAFPK dhe ofruesit e AFP-së) janë angazhuar në zhvillimin dhe zbatimin e Kornizës së Sigurimit të Cilësisë në AFP. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2023, institucionet (MFE, AKPA) kanë ndërmarrë disa hapa për zbatimin e procesit të optimizimit duke integruar në shkollën profesionale “Beqir Çela” shkollën profesionale “26 marsi” Kavajë dhe duke krijuar dy ofrues të optimizuar në fushën e shërbimeve dhe atë teknike në Korçë, ofrues të krijuar nga bashkimi i pesë shkollave profesionale në këtë bashki. Si rezultat, numri aktual i ofruesve të AFP-së është 39 (nga 44), 29 shkolla profesionale dhe 10 Drejtori Rajonale të formimit profesional publik.

Në këtë vit të procesit të vetëvlerësimit, ndryshe nga vitet e kaluara, u përfshinë 39 ofrues publikë të AFP-së, pasi disa ofrues iu nënshtruan procesit të optimizimit. Në zbatim të Urdhrit të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë ndodhën ndryshimet në shkollat profesionale, të cilat janë të listuara si më poshtë:

1. Riorganizimi i veprimtarisë së institucioneve arsimore Shkolla e Mesme Profesionale “Irakli Terova”, Shkolla e Mesme Profesionale “Isuf Gjata”, dhe Shkolla e Mesme Profesionale “Enver Qiraxhi”, (Drejtimi “Bujqësi”) në një institucion arsimor me emërtimin Shkolla Profesionale Shërbime, Korçë.
2. Riorganizimi nëpërmjet bashkimit të shkollave profesionale “Beqir Çela”, Durrës dhe 26 Marsi, Kavajë, në një menaxhim të vetëm Shkolla profesionale “Beqir Çela”, Durrës.
3. Riorganizimi i veprimtarisë së institucionit arsimor Shkolla e Mesme Profesionale, “Enver Qiraxhi”, Pogradec.
4. Riorganizimin nëpërmjet bashkimit të shkollave të mesme profesionale “Fan Noli”, Korçë, dhe Shkolla e Mesme Profesionale e Ndërtimit, Korçë, në një institucion arsimor të vetëm me emërtimin Shkolla Profesionale Teknike, Korçë.
5. Riorganizimin nëpërmjet bashkimit të Shkollës së Mesme Profesionale “Sali Ceka” Elbasan dhe Shkollës së Mesme Profesionale “Ali Myftiu” Elbasan në një institucion arsimor me emërtimin “Shkolla profesionale Elbasan”

Zbatimi i procesit të vetëvlerësimit në 39 ofrues publikë të AFP-së, ka evidentuar aspektet pozitive, si dhe aspektet problematike, në të pesë fushat e cilësisë. Rezultatet e vetëvlerësimit të ofruesve të AFP-së janë konsideruar nga secili prej tyre për hartimin e raportit kombëtar të vetëvlerësimit.

KUADRI RREGULLATOR PËR VETËVLETËSIMIN NË SISTEMIN E AFP-SË NË SHQIPËRI

Kuadri strategjik

Kuadri strategjik në AFP lidhet me Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023-2030, miratuar me Vendim nr. 173, datë 24.3.2023, *“Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023–2030, Planit të Veprimit për zbatimin e saj, si dhe Planit të Zbatimit të Garancisë Rinore 2023–2024”*. Vizioni dhe objektivat e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023–2030 janë pjesë e rëndësishme e angazhimit të Shqipërisë për zbatimin e Agjendës 2030 dhe i shërbejnë arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në vend.

Kuadri ligjor

Ligji nr. 15/2017, datë 16.2.2017 “Për arsimin dhe formimin profesional”, kreu V “Sigurimi i Cilësisë” përcakton bazën për zhvillimin e një kuadri të sigurimit të cilësisë në sistemin shqiptar të AFP-së, duke përfshirë licencimin, vetëvlerësimin, inspektimin dhe akreditimin.

Ligji nr. 10247, datë 4.3.2010 “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve” (KSHK), i ndryshuar dhe i përmirësuar në vitin 2018 (Ligji nr. 23/2018, datë 10.5.2018), përshkruan veçoritë kryesore

të KSHK-së, si strukturën, fushën e veprimit, objektivat dhe funksionet, si dhe masat për qeverisjen, menaxhimin institucional, sigurimin e cilësisë dhe financimin. Fokusi kryesor i parashikuar nga ligji, ndër shumë të tjera, thekson çështjen e sigurimit të cilësisë në AFP. Kjo do të thotë që të gjitha institucionet e arsimit dhe formimit profesional duhet të plotësojnë standarde të caktuara të cilësisë përsa i përket burimeve njerëzore dhe fizike, sistemeve dhe procedurave, menaxhimit, procesit të të nxënies etj. Sigurimi i cilësisë duhet të jetë guri i themelit i çdo institucioni që ofron arsim dhe formim profesional dhe një aspekt shumë i rëndësishëm për përmirësimin e imazhit të AFP-së dhe prodhimin e një force punëtore të kualifikuar për tregun e punës.

Për më tepër, kuadri ligjor për arsimin parauniversitar (Ligji nr. 69/2012 dhe legjislacioni dytësor përkatës) parashikon rregullat dhe kriteret për kuadrin e zhvillimit institucional dhe të cilësisë, veçanërisht për ofruesit e AFP-së që ofrojnë programe të arsimit të mesëm të lartë. Janë përcaktuar procedura dhe kriteret të qarta lidhur me : 1) planin strategjik afatmesëm (4 vjeçar); 2) planin vjetor të punës dhe 3) fushën e veprimit, zbatimin dhe përdorimin e vetëvlerësimit të institucioneve parauniversitare, duke përfshirë shkollat e AFP-së.

Së fundi, *Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 16, datë 8 maj 2018*, i cili miraton Udhëzuesin Zyrtar për vetëvlerësimin dhe përcakton përgjegjësitë e ofruesve dhe institucioneve në nivelin qendror, Udhëzimi i Ministrit nr. 16/1, datë 16 tetor 2018, i ndryshuar si dhe Udhëzimi nr 18 datë 07.06.2021, përcaktojnë arritjen e parë kyçe për një zbatim gjithëpërfshirës të kuadrit të sigurimit të cilësisë, duke përfshirë shkollat e AFP-së, dhe Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional Publik.

Kuadri institucional për sigurimin e cilësisë në AFP

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Në cilësinë e institucionit më të lartë përgjegjës për politikën e AFP-së, edhe për vitin shkollor 2022-2023, shkollat e mesme të arsimit profesional dhe Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional Publik kanë qenë në varësinë e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. MFE ka patur si detyrë krijimin e kuadrit të sigurimit të cilësisë në sistemin e AFP-së, duke përfshirë të gjithë komponentët e këtij sistemi, siç janë licencimi, hapja dhe mbyllja e ofruesve publikë të AFP-së, si dhe miratimi i legjislacionit dytësor për akreditimin, vetëvlerësimin, monitorimin dhe inspektimin. Më konkretisht, Ministria është përgjegjëse për zhvillimin e bazës ligjore, garantimin e burimeve të nevojshme njerëzore dhe financiare dhe sigurimin e infrastrukturës. Në sektorin publik, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka qenë përgjegjëse për miratimin e hapjes, organizimit dhe mbylljes së ofruesve publikë të AFP-së mbi bazën e kriterëve dhe procedurave të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave. Ajo ka miratuar ofrimin e programeve të AFP-së në bazë të kualifikimeve kombëtare të ofruara nga ofruesit publikë të AFP-së dhe ka miratuar modelin, standardet dhe kriteret e akreditimit të propozuara nga AKAFPK.

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

Procesi i vetëvlerësimit për vitin shkollor 2022-2023, ka nisur kur ofruesit e AFP-së kanë qenë në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Me vendimin nr. 30, datë 17.1.2024, *“Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit”*, arsimi dhe formimi profesional përfshihet në fushën e ekonomisë, në ministrinë e sapokrijuar, ku citohet në pikën 3, 3/1, germa ç) të vendimit.

Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK)

AKAFPK është institucioni përgjegjës për krijimin e një sistemi të unifikuar të kualifikimeve profesionale të njohura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, një sistem që u mundëson nxënësve/kursantëve/individëve të fitojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca për të përballuar sfidat e zhvillimit social-ekonomik të vendit. AKAFPK mbështet ministrinë përgjegjëse për të forcuar dimensionin evropian të sistemit shqiptar të kualifikimeve. Në sektorin e AFP-së, AKAFPK ka përgjegjësi dhe kompetencë të plotë për të ushtruar funksionet kryesore të KSHK-së. Ndër detyrat e tjera dhe në lidhje me zbatimin e ligjit për KSHK-në, AKAFPK kryen vlerësimet e kualifikimeve profesionale dhe i krahason ato me kualifikimet ndërkombëtare, si dhe propozon ndryshime në kriteret dhe procedurat për sigurimin e cilësisë së kualifikimeve të përfshira në KSHK.

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA)

Bazuar në nenin 9 të ligjit për AFP-në, AKPA është përgjegjëse për menaxhimin e rrjetit të ofruesve publikë të AFP-së. Me këtë detyrë, AKPA është përgjegjëse për monitorimin e veprimtarisë së përditshme të ofruesve të AFP-së. Krahas kësaj, AKPA-s i është besuar detyra e mirëmbajtjes dhe përditësimit të regjistrit kombëtar të certifikatave, si dhe detyra e gjurmimit të nxënësve të AFP-së pas diplomimit/certifikimit.

INSTRUMENTI DHE METODOLOGJIA E VETËVLERËSIMIT

Elementët e metodologjisë së vetëvlerësimit në AFP përfshijnë 5 dimensionet e cilësisë së veprimtarisë së ofruesve të AFP-së. Instrumenti i vetëvlerësimit i hartuar me mbështetjen e programit SD4E, ka shërbyer për të udhëhequr zbatimin e procesit të vetëvlerësimit dhe shpjegon në mënyrë të hollësishme të gjitha fushat, duke përfshirë nënfushat e secilës fushë. Ai përfshin përshkrimet e fushave, nënfushave, kriterëve, niveleve të vlerësimit dhe standardeve.

Fusha nënkupton një dimension themelor të veprimtarisë së ofruesit të AFP-së dhe lidhet drejtpërdrejt me të gjithë veprimtarinë e tij. Përcaktimi i fushave të veprimtarisë bazohet në aktet ligjore dhe nënligjore për arsimin profesional dhe arsimin e përgjithshëm. Janë përcaktuar këto fusha kryesore të vetëvlerësimit:

- I. Menaxhimi
- II. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi
- III. Kurrikula e zbatuar
- IV. Mësimdhënia dhe të nxëniet
- V. Vlerësimi

Nënfusha është një nën-ndarje me detaje dhe elemente që tregon dhe plotëson më së miri përmbajtjen e një fushe të caktuar në të cilën punon ofruesi i AFP-së. Për shembull, nëse njëra nga fushat është *“Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi”*, nënfushat janë *“Marrëdhëniet me komunitetin dhe shoqërinë civile”*, *“Marrëdhëniet me biznesin”* etj.

Këto nënfusha synojnë të identifikojnë se çfarë marrëdhëniesh dhe çfarë forma bashkëpunimi ka institucioni i AFP-së me partnerët e tij. Ato konsiderohen si një mundësi për të identifikuar, për të vëzhguar dhe për të vlerësuar në imtësi atë që ndodh brenda ofruesit të AFP-së. Pra nënfushat kryejnë dy funksione:

- zbërthejnë fushën në elementë organike të domosdoshme për të;
- mundësojnë njohjen dhe vlerësimin real të situatës brenda ofruesit të AFP-së.

Treguesi është një fjali e matshme pohuese që tregon se si është dhe si duhet të jetë fusha. Përmes treguesve, ne vlerësojmë se si është vetëvlerësuar ofruesi i AFP-së.

Karakteristikat e treguesve:

- hartohen për secilën nënfushë dhe mund të jenë një ose disa të tillë;
- janë gjithnjë të matshëm, gjë që do të thotë se ata lehtësojnë procesin e vetëvlerësimit;
- paraqesin pohime që specifikojnë fushën që do të vlerësohet.

Kriteri është një nën-ndarje e treguesve i shprehur në formën e një fjalie që përcakton si është zbatuar, si është organizuar apo në ç’gjëndje paraqitet treguesi. Ai sugjeron mbledhjen e informacioneve dhe mundëson arrijten e treguesve nga institucioni i AFP-së.

Nivelet e vlerësimit janë nivelet e përdorura për vlerësimin e institucionit të AFP-së nëpërmjet fushave të tij. Vlerësimi kryhet për çdo kriter të secilit tregues të një fushe. Nivelet e vlerësimit janë katër: shumë mirë, që përkon me numrin 1; mirë, që përkon me numrin 2; mjaftueshëm, që përkon me numrin 3; dhe dobët, që përkon me numrin 4. Skema me katër nivele vlerësimi është mjaft e përdorur në vlerësimet e ofruesve të AFP-së në vendet e Evropës. Po ashtu, ky sistem me katër nivele mundëson një vlerësim real dhe përfshin të gjitha nivelet që mund të arrijnë institucionet e AFP-së sipas treguesve.

Standardi është përshkrimi i situatës së ofruesit të AFP-së për secilën fushë, i cili mundëson një vlerësim sipas niveleve të mësipërme të vlerësimit. Ky vlerësim është rezultat i përpunimit të të dhënave të instrumenteve të monitorimit dhe vlerësimit të siguruara për secilin tregues dhe kriter, por edhe i të dhënave të siguruara nga metodologjia e zbatuar gjatë vlerësimit të brendshëm. Vlerësimi përfundimtar për një fushë specifike bazohet gjithmonë në peshën dhe rëndësinë e zbatimit të secilit tregues dhe kriter në situatën e ofruesit të AFP-së.

KALENDARI I ZBATIMIT TË PROCESIT TË VETËVLERËSIMIT PËR VITIN SHKOLLOR 2022-2023 NË OFRUESIT E AFP-SË

Nr.	Hapat që duhen ndërmarrë	Afatet	Personat përgjegjës
1	Krijimi i ekipit përgjegjës të vetëvlerësimit	2 tetor 2023	Drejtuesi i IoAFP-së
2	Miratimi i ekipit përgjegjës të vetëvlerësimit nga këshilli i mësimdhënësve	5 tetor 2023	Këshilli i mësimdhënësve
3	Hartimi i planit të vetëvlerësimit për 5 fushat e cilësisë	9 tetor 2023	Ekipi përgjegjës i vetëvlerësimit
4	Miratimi i planit të vetëvlerësimit nga drejtuesi i IoAFP-së	12 tetor 2023	Drejtuesi i IoAFP-së
5	Zbatimi i procesit të vetëvlerësimit për 5 fushat e cilësisë duke përdorur edhe platformën digjitale www.scvet.al (plotësimi i pyetësorëve, vëzhgime, mbledhje informacioni, etj.)	29 dhjetor 2023	Ekipi përgjegjës i vetëvlerësimit/ Drejtuesi i IoAFP-së/Bordi i IoAFP-së/ mësimdhënësit/Stafi mbështetës/ nxënësit/kursantët/ bizneset
6	Përpunimi i të dhënave dhe hartimi i raportit të vetëvlerësimit për 5 fushat e cilësisë, duke përfshirë në raport “Instrumentin për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë”	15 janar 2024	Ekipi përgjegjës i vetëvlerësimit
7	Përgatitja e raportit final të vetëvlerësimit për 5 fushat e cilësisë	26 janar 2024	Ekipi përgjegjës i vetëvlerësimit
8	Monitorimi dhe mbështetja e procesit të vetëvlerësimit nga specialistë të AKAFPK-së	tetor 2023-janar 2024	Specialistë të AKAFPK-së
9	Prezantimi i raportit final të vetëvlerësimit në këshillin e mësimdhënësve dhe miratimi i tij nga bordi i IoAFP-së	29 janar 2024	Drejtuesi i IoAFP-së/ këshilli i mësimdhënësve /Bordi i IoAFP-së
10	Hedhja e raportit final të vetëvlerësimit në platformën digjitale www.scvet.al	31 janar 2024	Drejtuesi i IoAFP-së

REZULTATET E PROCESIT TË VETËVLERËSIMIT

PËR VITIN SHKOLLOR 2022-2023

Procesi i vetëvlërësimit u finalizua nga 39 ofrues të AFP-së me dorëzimin e raporteve të vetëvlërësimit për vitin shkollor 2022-2023. Rezultatet e raporteve u përmbledhën dhe u përpunuan nga specialistët e AKAFPK-së në sektorin e akreditimit të ofruesve të AFP-së, të cilët analizuan të dhënat sasiore dhe cilësore, të mbledhura nga raportet dhe platforma scvet.al. AKAFPK-ja ka mbajtur një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me secilin nga 39 ofruesit e AFP-ve, ku secilit i është dhënë mbështetje në realizimin e këtij procesi, i është komunikuar progresi i arritur si dhe është diskutuar për mangësitë që kanë patur.

Raporti ka marrë në konsideratë në mënyrë të përmbledhur të gjitha nënfushat e të *pesë* fushave të cilësisë që përdor instrumenti i *vetëvlërësimit* për të matur ecurinë e cilësisë të ofruesit të AFP-së. Çdo nënfushë do të ndahet në dy pjesë ku në pjesën e parë do të renditet *rezultati* që është arritur kurse në pjesën e dytë do të vihen në dukje *dobësitë*. Në vijim janë paraqitur nëpërmjet paraqitjes në formë grafike rezultatet sasiore si dhe rezultatet cilësore për secilin prej ofruesve të AFP-së.

Në përmbledhjen e raportit, janë formuluar rekomandimet përkatëse për çështjet që duhen përmirësuar në të ardhmen.

FUSHA 1: MENAXHIMI DHE DREJTIMI

IoAFP-të kanë zbatuar procesin e vetëvlërësimit për vitin shkollor 2022-2023 dhe e kanë dorëzuar pranë AKAFPK-së brenda datave të paracaktuara.

Përgjatë verifikimit të fushës së parë “Menaxhimi dhe drejtimi”, IoAFP-të kanë zhvilluar aftësi organizative duke ngritur grupe pune, duke ndarë role dhe procese për çdo grup pune.

Ka një përfshirje të stafit mësimor, të cilët janë kontribuues në hartimin e raportit të vetëvlërësimit, duke zhvilluar një proces transparent, bashkëpunues dhe gjithëpërfshirës.

Më poshtë listohen nënfushat me zhvillimet që ato paraqesin në rang kombëtar për të gjithë IoAFP-të.

1. Gjithëpërfshirja
2. Plan i afatmesëm i ofruesve të AFP-së
3. Plan i vjetor i ofruesve të AFP-së
4. Plan i vëzhgimit të orëve mësimore
5. Plan i monitorimit të dokumentacionit institucional

6. Statistikat e ofruesve të AFP-së, regjistrimi dhe transferimi i nxënësve
7. Vetëvlerësimi/vlerësimi i brendshëm i ofruesve të AFP-së
8. Zhvillimi profesional i stafit
9. Efektiviteti i burimeve njerëzore dhe financiare

1. Gjithëpërfshirja

a. Rezultati

IoAFP-të kanë zbatuar të gjitha udhëzimet për organizimin dhe funksionimin e strukturave të tyre si: Bordi i IoAFP-së, Këshilli i mësuesve, Qeveria e nxënësve, Këshilli i prindërve të IoAFP-së, Këshilli i Prindërve të Klasës, Komisioni i Disiplinës, Komisioni i Etikës dhe Sjelljes. Këto struktura operojnë më së shumti bazuar me planin vjetor të tyre, tashmë kanë një bashkëpunim më koherent dhe të sinkronizuar mes tyre, i cili evidentohet nëpërmjet dokumentacionit. Drejtoritë e IoAFP-ve kujdesen që periodikisht të zhvillohen takime në të cilat kërkohen dhe merren parasysh opinionet dhe vlerësimet e stafit në lidhje me performancën dhe progresin e institucionit.

b. Dobësitë

Një dobësi që është mbartur ndër vite, kjo dhe për shkak të kontekstit social-kulturor, është përfshirja e prindërve, dobësi e cila është zbehur me përpjekjet e IoAFP-ve, por ka ende punë për të arritur rezultate maksimale. Ndër strukturat që ka më pak përfshirje, pjesëmarrje aktive apo organizime periodike krahasuar me të tjerat është Këshilli i prindërve, i cili ka raste të veprimit pa një plan vjetor të përgatitur më herët.

2. Plani afatmesëm i ofruesve të AFP-së

a. Rezultati

Planet afatmesme tashmë pasqyrojnë një cilësi më të lartë në hartimin e tyre dhe i përgjigjen mjaft mirë strategjisë kombëtare të punësimit dhe kërkesave të tjera për hartimin e tyre. Megjithatë mbetet ende vend për përmirësim deri në paraqitjen optimale të këtyre planeve.

b. Dobësitë

Një mangësi që vërehet, e cila mund të çenojë rezultatet e një plani afatmesëm të mirë hartuar, është mungesa e ekipeve mbikëqyrëse për vëzhgimin dhe zbatimin e planit afatmesëm. Mbikëqyrja e zbatimit të planit afatmesëm është e një rëndësie të lartë për dhënien e rezultateve të planifikuara nga IoAFP-të dhe rekomandohet që këto ekipe mbikëqyrëse të krijohen tek ata ofrues që nuk janë formuar ende si dhe të jenë më aktive tek ofruesit që i kanë tashmë ekzistente këto ekipe.

3. Plani vjetor i ofruesve të AFP-së

a. Rezultati

Planet vjetore hartohen nga ofruesit e AFP-së dhe reflektojnë zbërthimin më me detaje të planit afatmesëm. Aktorët e brendshëm të ofruesit bashkëpunojnë në hartimin e planit vjetor si dhe merren në konsideratë edhe sugjerime që këta aktorë të brendshëm japin, gjithashtu plani vjetor verifikohet dhe miratohet nga Bordi i ofruesit.

b. Dobësitë

Një mangësi që mbetet për tu përmirësuar në vazhdim është përfshirja e objektivave që pasqyrojnë veprimtari me aspekte gjinore në planin vjetor. Disa IoAFP deklarojnë se i kanë përfshirë pjesërisht ose aspak në planin e tyre.

4. Plani i vëzhgimit të orëve mësimore

a. Rezultati

Plani i vëzhgimit të orëve mësimore realizohet në përputhje me kërkesat ligjore. Pjesa më e madhe e Drejtuesve të IoAFP-ve kryejnë vëzhgime periodike dhe mbajnë shënimet përkatëse për të përmirësuar veprimtarinë e mësimdhënies apo për të kontrolluar dhe vlerësuar ecurinë e nxënësve.

b. Dobësitë

Ekzistojnë ende raste ku Drejtuesit e IoAFP-ve nuk zhvillojnë miniteste sistematikisht ose jo për të gjitha kualifikimet profesionale. Gjithashtu vijon një numër i konsiderueshëm ofruesish të cilët nuk analizojnë gjetjet e orëve të vëzhguara, ose nuk i kanë të dokumentuara nëpërmjet raportit të vëzhgimit. Për më tepër vijnë rastet ku raportet e vëzhgimit të orëve mësimore nuk përfshijnë aspekte gjinore. Në vijimësinë e viteve është referuar se cilësia e dokumentimit të punës dhe matja e saj duhet të përmirësohet, madje të krijohet një format dhe raport standard për vëzhgimin e orëve i cili do të përfshijë aspektet e sipërcituara.

5. Plani i monitorimit të dokumentacionit institucional

a. Rezultati

Ofruesit kanë arritur të planifikojnë, ndjekin dhe monitorojnë mjaft mirë plotësimin dhe ruajtjen e dokumentacionit institucional.

b. Dobësitë

Del në pah si mangësi për një numër të konsiderueshëm ofruesish bërja e librit të inventarit një dokument transparent për IoAFP dhe komunitetin.

6. Statistikat e ofruesve të AFP-së, regjistrimi dhe transferimi i nxënësve/kursantëve

a. Rezultati

Procedurat e regjistrimit dhe transferimit të nxënësve/kursantëve janë të rregullta dhe realizohen sipas udhëzimeve. Gjithashtu ofruesit kanë krijuar databazat e tyre dhe mbajnë të dhëna statistikore të nevojshme për veprimtarinë e tyre dhe raportimin në institucionet eprore.

b. Dobësitë

Nuk janë raportuar mangësi në këtë nënfushë.

7. Vetëvlerësimi/vlerësimi i brendshëm i ofruesve të AFP-së

a. Rezultati

IoAFP-të kryejnë vlerësimin e tyre të brendshëm vjetor, duke zbatuar udhëzimet dhe duke ngritur grupet e punës përgjegjëse për zhvillimin e këtij procesi.

b. Dobësitë

Mangësitë që raportohen në këtë nënfushë janë: kryerja e vetëvlerësimit nga të gjithë mësimmshënësit me instrument standard si dhe ekipeve të drejtimit profesional, në disa ofrues nuk realizohet si veprimtari. Gjithashtu problematikë e mbartur ndër vite është publikimi i raportit përfundimtar nga ofruesit në faqet e tyre të internetit, shumica e tyre nuk kanë një faqe funksionale.

8. Zhvillimi profesional i stafit

a. Rezultati

Drejtuesit e ofruesve të AFP-së kanë përgjegjësi të qarta dhe angazhohen për trajnimin dhe kualifikimin e personelit të institucionit. Nevojat për trajnim dhe kualifikim identifikohen në kohë si dhe ndiqen kualifikime të detyrueshme në përputhje me kriteret zyrtare.

b. Dobësitë

Disa ofrues nuk kanë një plan pune për shkëmbimet e përvojave profesionale të mësuesve midis dhe brenda ekipeve kurrikulare, por dhe nëpërmjet rrjeteve profesionale të takimeve të drejtpërdrejta dhe atyre online.

9. Efektiviteti i burimeve njerëzore dhe financiare


a. Rezultati

Drejtuesit e IoAFP-ve menaxhojnë efektivisht burimet njerëzore dhe financiare që disponojnë, si dhe identifikojnë nevojat për personel shtesë apo burime financiare. Buxheti i aprovuar nga institucionet përgjegjëse menaxhohet kurdoherë sipas kërkesave ligjore. Gjithashtu burimet njerëzore kanë detyra të qarta si dhe nxiten për të pasur një bashkëpunim të suksesshëm midis tyre.


b. Dobësitë

Disa ofrues hasin vështirësi për të nxitur pjesëmarrjen aktive të të gjithë mësimdhënësve në veprimtaritë ndërkurrikulare që organizojnë ekipet ku përfshihen apo shkolla në tërësi. Përsa i përket përdorimit të buxhetit, ai menaxhohet efektivisht sipas kërkesave ligjore por jo gjithmonë ofruesit ekspozojnë dhe shfaqin në mjedise të dukshme për grupet e interesit shpenzimet financiare.


Në grafikun e mëposhtëm paraqitet vlerësimi për secilin prej 39 ofruesve të AFP-së , për fushën 1 “Menaxhimi dhe drejtimi”.



Nga analiza e rezultateve të vetëvlerësimit u arrit në përfundimin se 28 prej ofruesve publikë të AFP-së, për fushën 1“Menaxhimi dhe drejtimi” e kanë vlerësuar veten “Shumë mirë”, 11 prej tyre e kanë vlerësuar veten “Mirë”. Ndërkohë nuk e kanë vlerësuar asnjë prej ofruesve “Mjaftueshëm” ose “Dobët”.



Në grafikun e mëposhtëm tregohet vlerësimi për secilën nënfushë të Fushës 1.



FUSHA 2 - MARRËDHËNIET DHE BASHKËPUNIMI

Fusha e dytë e vetëvlerësimit përfshin "Marrëdhëniet dhe Bashkëpunimi" thelbësore për të vlerësuar nivelin e bashkëpunimit që ofruesi i AFP-së zhvillon, pasi është pikë referimi për suksesin dhe arritjen e qëllimeve të veta. Ofruesi i AFP-së ka një liri të gjerë për të përdorur çdo formë të bashkëpunimit me qëllim të përmirësimit dhe profesionalizimit të shërbimit të AFP-së. Realizimi i këtyre veprimtarive ndihmon në rritjen e besueshmërisë dhe konkurrueshmërisë në treg.

Fusha 2 përbëhet nga katër nënfushat në vijim:

1. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me qeverisjen qendrore, rajonale dhe vendore.
2. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me biznesin.
3. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe komunitetin
4. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi midis vet ofruesve të AFP-së dhe institucioneve.

1. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me qeverisjen qendrore, rajonale dhe vendore

a. Rezultati

Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi midis IoAFP-ve dhe Institucioneve qendrore dhe lokale të çështjeve të AFP-së dhe të arsimit, karakterizohen nga një stabilitet dhe bashkërendim. Zbatohen

kërkesat ligjore, ka komunikime zyrtare, raportime të herëpashershme, ftesa për pjesëmarrje në aktivitete të ndërsjella.

b. Dobësitë

Përsa i përket bashkëpunimit me qeverisjen vendore, IoAFP-të kanë arritur të forcojnë më tepër marrëdhëniet me këto institucione, por ende hasen problematika në disa drejtime. Shumë ofrues ende nuk kanë arritur një bashkëpunim të plotë për zhvillimin e praktikave profesionale në institucionet e qeverisjes lokale. Dobësi që vijon të mbartet ndër vite me të njëjtin rezultat është planifikimi dhe zbatimi i veprimtarive me aspekte gjinore me pushtetin lokal/institucionet vendore. Ofruesit kanë marrë masa për përmirësimin e kësaj pike të dobët, por nuk kanë rezultuar efektive.

2. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me biznesin

a. Rezultati

Niveli i marrëdhënieve dhe bashkëpunimit me biznesin është konsoliduar dhe vazhdojnë të qëndrojnë në të njëjtin nivel, pa përmirësime të dukshme. Komunikimi dhe bashkëveprimi midis tyre realizohet nëpërmjet Njesisë së Zhvillimit, i dokumentuar sipas dosjes së punës me planet periodike, marrëveshjet, kontratat tip, databazën e bizneseve, evidenca të tjera për praktikën e nxënësve.

b. Dobësitë

Pika të dobëta që mbarten ndër vite janë planifikimi dhe zbatimi i veprimtarive me aspekte gjinore me biznesin, masat e marra nga ofruesit vazhdojnë mos të kenë efekte përmirësimi. Disa ofrues nuk tregohen të përpiktë me kryerjen e analizës së tregut për zonën e veprimtarisë së tyre, ata nuk i kryejnë këto analiza të detajuara, ose nuk i realizojnë për çdo kualifikim që ofrojnë. Gjithashtu Njësia e Zhvillimit e disa ofruesve ka paraqitur vështirësi në identifikimin e punonjësve të kualifikuar në biznese, punonjës të cilët mund të zhvillojnë tema të ndryshme në shkollë.

3. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe komunitetin

a. Rezultati

Kjo nënfushë mbetet pa përmirësime të dukshme. IoAFP-të duket se hasin në vështirësi për të bashkëpunuar me komunitetin dhe shoqërinë civile. Ofruesit kanë arritur të krijojnë një plan më efektiv për përfshirjen e prindërve, marrëdhënie që është kthyer disi e qëndrueshme por jo në çdo dimension të jetës institucionale. Ofruesit që kanë krijuar databazat për identifikimin e OJF-ve i kanë mirëmbajtur ato por nuk janë shtuar ofrues të tjerë që kanë kryer këtë identifikim.

b. Dobësitë

Pavarësisht masave dhe veprimtarive që ofruesit kanë ndërmarrë ende ngelet si sfida shtimi i numrit të prindërve që marrin pjesë aktivisht në vlerësimin e brendshëm, hartimin e planeve, pjesëmarrjen në aktivitete ekstrakurrikulare etj. Mjaft ofrues nuk kanë bashkëpunuar me komunitetin për studime dhe analiza të nevojave të tregut të punës, por dhe për projekte të ndryshme që lidhen me edukimin dhe barazinë gjinore. Bashkëpunimi me shoqërinë civile është pika më e dobët e pjesës më të madhe të IoAFP-ve, nisur nga fakti që nuk kanë identifikuar OJF-të, ose rastet kur i kanë identifikuar nuk kanë mirëmbajtur një bazë të dhënash, ata nuk kanë komunikim sistematik me këto organizata. Gjithashtu ofruesit nuk kanë mundur të rrisin kapacitetin për hartimin e projekteve zhvillimore për të siguruar mbështetje nga OJF-të. Shumë ofrues edhe këtë vit nuk kanë planifikuar dhe zbatuar veprimtari me aspekte gjinore në bashkëpunim me komunitetin dhe shoqërinë civile.

4. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi midis vet ofruesve të AFP-së dhe institucioneve


a. Rezultati

Ofruesit e AFP-së vazhdojnë të kenë marrëdhënie të qëndrueshme me shkollat e arsimit bazë për zhvillimin e veprimtarive të këshillimit të karrierës. Nëpërmjet këtyre marrëdhënieve ofruesit kanë mundësinë të zbatojnë planin e tyre të promovimit nëpërmjet ditëve të hapura. Promovimi i AFP-së realizohet dhe nëpërmjet panairëve, konferencave, publikimeve të printuara dhe komunikimeve online, veprimtari të cilat dokumentohen dhe ruhen pranë ofruesve.


b. Dobësitë

Ofruesit e AFP-së vazhdojnë të paraqesin dobësi në krijimin e binjakëzimeve me institucione homologe brenda apo jashtë vendit. Ata kanë pasur raste të bashkëpunimit, por jo një marrëveshje binjakëzimi. Pika më e dobët në këtë nënfushë për më tepër se 50% të ofruesve mbetet bashkëpunimi me institucione të arsimit post sekondar dhe atij të lartë për zhvillim profesional. Nuk ekzistojnë, ose janë të rralla bashkëpunime të përbashkëta me institucione të arsimit post sekondar dhe atij të lartë për përgatitjen profesionale të nxënësve/kursantëve dhe kjo si pasojë e mos përfshirjes së institucioneve të arsimit të lartë edhe pse nga IoAFP-të ka pasur propozime. Këto institucione përfshihen vetëm në veprimtaritë e promovimit të tyre pranë IoAFP-ve. Gjithashtu nuk ka patur bashkëpunim me këto institucione përsa i përket trajnimit të stafit dhe përmirësimin dhe rifreskimin e kurrikulës së përgatitjes profesionale, si dhe për materiale mbështetëse.


Në formë grafike rezultati i fushës "Marrëdhëniet dhe Bashkëpunimi" për ofruesit e AFP-së do të paraqitet si më poshtë:



Në formë grafike rezultati i nënfushave të Fushës 2 “Marrëdhëniet dhe Bashkëpunimi” do të paraqitet si më poshtë:



Nga analiza e ofruesve të AFP-së për fushën “Marrëdhëniet dhe Bashkëpunimi” ka rezultuar se 18 prej tyre e shohin vetën “Shumë mirë” në këtë fushë, 20 prej tyre e shohin veten “Mirë”, 1 prej tyre e shoh veten “Mjaftueshëm”, asnjë ofrues nuk e ka vlerësuar veten “Dobët. Të dhënat janë paraqitur në figurën e mëposhtme:



FUSHA 3-KURRIKULA E ZBATUAR

Kjo fushë lidhet me zhvillimin e kurrikulës së ofruesit të AFP-së në përputhje me standardet e profesioneve dhe standardet e kualifikimeve profesionale brenda autonomisë së ofruesit të AFP-së për hartimin dhe zbatimin e saj në nivel ofruesi si dhe mundëson formimin e kompetencave kyçe dhe kompetencave profesionale. Fusha 3 përbëhet nga 5 nënfushat si më poshtë:

1. Kurrikula me bazë shkolle të AFP-së
2. Kurrikula në bazë ofruesi të FP-së
3. Kurrikula e formimit të përgjithshëm
4. Mbështetja për zbatimin e kurrikulës
5. Ekipi kurrikular

1. Kurrikula me bazë shkolle të AFP-së

a. Rezultati

Kjo nënfushë plotësohet vetëm nga shkollat e arsimit profesional. Nga raportimet e ofruesve të AFP-së rezulton se përmbushet në nivelin e kërkuar. Plani i zhvillimit të orëve mësimore teorike profesionale, si dhe plani i zhvillimit të moduleve praktike hartohen dhe zbatohen në përputhje me skeletkurrikulat e kualifikimeve profesionale të niveleve përkatëse të hartuara dhe të miratuara nga AKAFPK, duke ruajtur të njëjtat objektiva, tema dhe kohëzgjatje. Planet mësimore vihen në zbatim pas miratimit nga drejtori i shkollës.

b. Dobësitë

Nga analiza e raporteve të vetëvlerësimeve të ofruesve të AFP-së si dhe nga të dhënat e plotësuar në platformën *scvet.al*, nuk janë konstatuar dobësi të theksuara për të bërë përgjithësime në nivel kombëtar, për këtë nënfishë.

2. Kurrikula në bazë ofruesi të FP-së

a. Rezultati

Ky kriter plotësohet nga Qendrat e Formimit Profesional dhe nga shkollat që ofrojnë kurse të unifikuara. Në nivel kombëtar nuk janë evidentuar problematika. Programet e kurseve zhvillohen në përputhje me dokumentet zyrtare, si dhe me nevojat e tregut të punës. Vlerësimet që ofruesit e AFP-së kanë dhënë për veten e tyre janë në nivelin “shumë mirë” ose “mirë”.

b. Dobësitë

Nga analiza e raporteve të vetëvlerësimit si dhe të dhënat në platformën elektronike u konstatua se në vitin 2022 vetëm në dy Drejtori Rajonale të Formimit Profesional Publik, kanë raportuar se janë identifikuar nevojat për kurse afatshkurtër por nuk janë realizuar për arsye bazash materiale. Një tjetër Drejtori Rajonale e Formimit Profesional Publik ka raportuar se analiza e nevojave të tregut lokal dhe rajonal zhvillohet çdo vit, por nuk dokumentohet.

3. Kurrikula e formimit të përgjithshëm

a. Rezultati

Në këtë nënfishë Planet tremujore ose vjetore lëndore hartohen në përputhje me dokumentet kurrikulare, duke përcaktuar shpërndarjen e kohës për të gjitha lëndët, si dhe elementët e tjera të kërkuara. Në planet ditore mësimdhënësit përcaktojnë edhe arritjen e rezultateve mësimore ndërkurrikulare. Mësuesi ka hartuar/përcaktuar detyra/punë të pavarura interesante dhe sfiduese, për nxënësit, ku ngre çështje dhe probleme të rëndësishme, që synojnë zhvillimin e kompetencave. Në ofruesit e AFP-së bëhen përpjekje për të planifikuar veprimtari të diferencuara për nxënësit me nevoja të veçanta, nga mësuesi kujdestar dhe mësuesi mbështetës.

b. Dobësitë

Nga analiza e raporteve të vetëvlerësimit dhe të dhënave në platformën elektronike të vetëvlerësimit, për vitin shkollor 2022-2023, është konstatuar se në rreth gjysmën e ofruesve të AFP-së nuk ka bashkëpunim me prindërit për tematikat dhe realizimin e projekteve kurrikulare. Prindërit në këto veprimtari përfshihen shumë rrallë ose asnjëherë. Në disa raste bashkëpunimi nuk është sistematik, për arsye të interesit të ulët të prindërve që në shumë raste vjen edhe si pasojë e distancës nga shkolla. Mësimdhënësit hartojnë detyra dhe punë të pavarura, interesante dhe sfiduese, për nxënësit, ku ngre çështje dhe probleme të rëndësishme për të zhvilluar kompetencat e nxënësve por mungon trajtimi i çështjeve të barazisë gjinore, evidentuar kjo në relacionet e kontrollit të ditareve. Disa ofrues kanë raportuar se çështjet e barazisë gjinore

trajtohen vetëm në disa lëndë. Në lidhje me përcaktimin në planin ditor të nxënësve që do të vlerësohen, analizat tregojnë se ofruesit nuk i planifikojnë nxënësit që do të vlerësojnë, referuar kjo nga kontrolli i planeve ditore. Disa ofrues i përcaktojnë nxënësit që do të vlerësohen por nuk i pasqyrojnë në planin ditor. Lidhur me raportet përfundimtare të projekteve një pjesë e ofruesve kanë deklaruar se raportet përfundimtare ose mungojnë, ose nuk përmbajnë të gjitha elementët që kërkohen nga vetëvlerësimi si p.sh., gjetjet më të rëndësishme ose dosjet e projekteve. Këto janë mangësi të cilat janë konstatuar edhe vitin e kaluar.

4. Mbështetja për zbatimin e kurrikulës

a. Rezultati

Si çdo vit shkollor, nxënësit kanë tekste mësimore për lëndët e kulturës së përgjithshme, të cilat ndjekin procedurat zyrtare të përzgjedhjes, sipas udhëzimeve të MAS. Për lëndët e kulturës profesionale ofruesit mbështeten në materialet mësimore mbështetëse të hartuara nga AKAFPK, si dhe ato që sigurohen nga mësimdhënësit e kulturës profesionale. Ofruesit kanë mjediset e veçanta për realizimin e orëve praktike si dhe mjetet e nevojshme për kualifikimet profesionale dhe kurset që ofron. Përgjithësisht, merren masat përkatëse nga ofruesit për sigurinë e nxënësve gjatë kryerjes së veprimtarive praktike. Mësimdhënësit bashkëpunojnë me nxënësit për krijimin e mjeteve mësimore sipas mundësive të tyre. Gjithashtu, mësimdhënësit marrin pjesë edhe në përzgjedhjen e teksteve mësimore të nxënësve. Ambientet e zhvillimit të praktikave dhe ambientet ekzistuese të edukimit fizik janë të mirëmbajtura dhe të pastra.

b. Dobësitë

Nga analiza e të dhënave të gjeneruara nga platforma elektronike *scvet.al*, si dhe nga të dhënat në raportin e vetëvlerësimit u konstatua se bashkëpunimi i prindërve me ofruesit e AFP-së për krijimin e mjeteve mësimore, përgjithësisht mungon. Kjo vjen si rezultat i statusit social-ekonomik të familjeve. Në disa ofrues ky bashkëpunim është shumë i rrallë. Jo të gjithë ofruesit janë të pajisur me laboratorët e shkencave të natyrës për lëndët e kulturës së përgjithshme. Në shumë prej ofruesve, mjediset e edukimit fizik duhet të përmirësohen dhe të pajisen me palestër për të realizuar orën mësimore të edukimit fizik. Ka mungesë të theksuar të teksteve profesionale, por mësimdhënësit e kulturës profesionale bëjnë përpjekje për t'i hartuar vetë ato, në përputhje me kërkesat e skeletkurrikulave.

5. Ekipi kurrikular

a. Rezultati


Ofruesit e AFP-së kanë ngritur ekipet lëndore për lëndët e kulturës së përgjithshme si dhe departamentet e drejtimeve profesionale në përputhje me kërkesat zyrtare. Departamentet e drejtimeve hartojnë programet e mësimdhënies të lëndëve teorike profesionale si dhe të moduleve praktike. Ato miratojnë të gjitha planet që hartohen nga ekipet lëndore. Bëhet

përzgjedhja e projekteve që do t'u ofrohen nxënësve, pas propozimeve të ekipit lëndor të kurrikulës së formimit të përgjithshëm.


b. Dobësitë

Nga analiza e nënfushës ka rezultuar se nuk ka përfshirje të mjaftueshme të anëtarëve të Bordit të shkollës dhe prindërve në mbledhjet e departamenteve.


Rezultati i fushës 3 “Kurrikula e zbatuar” për 39 ofruesit publikë të AFP-së paraqitet në këtë mënyrë si më poshtë:



Nga analiza e ofruesve të AFP-së për fushën 3: “Kurrikula e zbatuar” është arritur në përfundimin se 24 ofrues publikë të AFP-së, e kanë vlerësuar veten “Shumë mirë”, 15 prej tyre e kanë vlerësuar vetën “Mirë”. Nuk ka asnjë ofrues AFP-je që e ka vlerësuar veten “Mjaftueshëm” ose “Dobët”.



Në grafikun e mëposhtëm tregohet vlerësimi i nënfushave për ofruesit e AFP-së për fushën 3: “Kurrikula e zbatuar”.



FUSHA 4 –MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT

Kjo fushë lidhet me dy procese thelbësore të cilat synojnë përvetësimin e njohurive, shprehive dhe kompetencave kyçe dhe profesionale të nxënësit/kursantit në përmbushje të kërkesave të standardeve të profesioneve dhe kualifikimeve profesionale.

Fusha 4 “Mësimdhënia dhe të nxënës” përbëhet nga 9 nënfushat si më poshtë:

1. Plani ditor
2. Rezultatet mësimore
3. Parimet kryesore gjatë orës së mësimi
4. Ana Shkencore
5. Baza materiale dhe didaktike
6. Mjedisi fizik
7. Metodologjia
8. Detyrat e shtëpisë
9. Përsëritja
10. Mjedisi i sigurt për të nxënës
11. Nxënësit dhe kursanti me nevoja të veçanta

1. Plani ditor

a. Rezultati

Mësimdhënësit bëjnë planifikimin e çdo ore mësimore duke u bazuar te programet e mësimdhënies së lëndëve teorike profesionale dhe programet e mësimdhënies të moduleve praktike profesionale. Ata gëzojnë autonominë profesionale në hartimin e planit, duke parashikuar kohën për çdo veprimtari mësimore të planifikuar që lidhet me njohuritë e reja, përsëritjen, kohën për refleksion, kërkesat përkatëse për vlerësimin e nxënësve si dhe detyra shtëpie. Planet mësimore përmbajnë elementët e kërkuara; Tema e orës mësimore, Rezultatet sipas programit mësimor, Rezultatet e orës mësimore, Plani e orëve mësimore, Vlerësimin, Detyrat e shtëpisë, dhe Refleksione. Mësimdhënësit dhe instruktorët përcaktojnë materialet dhe mjetet didaktike që duhen për zhvillimin normal të mësimi.

b. Dobësitë

Nga analiza e të dhënave të analizuara nga vetëvlerësimi, është arritur në përfundimin se mësimdhënësit nuk mbajnë rregullisht, në planin ditor, të dhëna mbi mangësitë tipike të nxënësve dhe kursantëve me vështirësi në të nxënë. Mësimdhënësit dhe instruktorët nuk paraqesin rregullisht rezultate të lidhura ngushtë me njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që synohen në fund të orës mësimore, të cilat përfshijnë dhe edukimin e barazisë gjinore. Në disa raste mungojnë rezultatet që lidhen me edukimin e barazisë gjinore dhe në disa raste të tjera nuk paraqiten nga të gjithë mësimdhënësit.

2. Rezultatet mësimore

a. Rezultati

Nga analiza e të dhënave të raporteve të vetëvlerësimit si dhe platforma scvet.al, u arrit në përfundimin se koha e planifikuar për çdo veprimtari mësimore zbatohet me rigorozitet, në ofruesit e AFP-së. Mësimdhënësit dhe instruktorët paraqesin në fillim të orës së mësimi objektivat që duhen arritur dhe në fund të orës mësimore paraqesin arritjen e rezultateve nga nivelet e ndryshme të nxënësve dhe kursantëve. Herë pas herë zhvillohen rregullisht miniteste për rezultatet e orës mësimore. Tekstet dhe materialet mësimore të përgatitura nga mësimdhënësit lidhen ngushtë me objektivat dhe rezultatet mësimore që synohet të arrihen.

b. Dobësitë

Duke identifikuar pikat e dobëta për këtë nënfushë, u konstatua se plani i orës mësimore i zhvilluar jo gjithmonë dhe jo në të gjithë ofruesit mundëson që një pjesë e nxënësve dhe kursantëve të kenë arritur rezultatet e nivelit mesatar dhe të lartë të orës mësimore. Kjo varet nga niveli i klasës. Vetëm një numër i vogël nxënësish arrijnë rezultate të nivelit të lartë.

3. Parimet kryesore gjatë orës së mësimi

a. Rezultati

Mësimdhënësit vënë vazhdimisht nxënësit dhe kursantët përballë sfidave të të nxënit, brenda nivelit të vështirësive të kualifikimit ku studiojnë. Synohet integrimi i njohurive, dhe koncepteve të sapo mësuara me njohuritë dhe konceptet e mësuara të lëndëve apo moduleve të tjera. Nuk ka pa barazi në trajtimin e nxënësve gjatë ndarjes dhe dhënies së detyrave. Nxënësve dhe kursantëve u kërkohet të mos kufizohen vetëm në shtjellimin teorik të lëndës, por ta konkretizojnë rregullisht me ngjarje, shembuj dhe situata të jetës së përditshme.

b. Dobësitë

Nuk janë konstatuar mangësi në lidhje me këtë nënfushë për të bërë përgjithësime në nivel kombëtar.

4. Ana Shkencore

a. Rezultati

Mësimdhënësit dhe instruktorët kanë aftësitë dhe njohuritë e duhura për të dhënë përgjigje të sakta për pyetjet që përmban teksti i nxënësit dhe të zgjidhë saktë kërkesat të tilla si ushtrime dhe problema. Ata nuk kanë mangësi në zotërimin e koncepteve themelore bashkëkohore të lëndës/modulit, në lidhjet mes këtyre koncepteve apo në metodat tipike bashkëkohore të kërkimit shkencor. Mësimdhënësit dhe instruktorët mund të japin shpjegime për lidhjet shkencore të lëndës me lëndë të tjera ose të aftësive praktike të modulit të mëparshëm me aftësitë që duhen krijuar duke zotëruar njohuri të mjaftueshme të lëndëve të tjera, të cilat janë të domosdoshme për zhvillimin e lëndës.

b. Dobësitë

Nga analiza e raporteve të vetëvlerësimit si dhe të dhënat e gjeneruara nga *scvet.al*, nuk janë konstatuar mangësi për këtë nënfushë.

5. Baza materiale dhe didaktike

a. Rezultati

Baza materiale dhe didaktike e planifikuar për mësim përdoret plotësisht në orën mësimore. Mësuesi përdor TIK-un në mësim, si instrument për zhvillimin e programeve të lëndëve të kulturës së përgjithshme dhe profesionale, në varësi të përmbajtjes dhe rezultateve mësimore. Në pak raste, një pjesë e mësimdhënësve, ofruesit e AFP-ve kanë një bashkëpunim të efektshëm me nxënësit për krijimin e mjeteve mësimore. Mësuesit dhe instruktorët përgatisin dhe vetë mjete mësimore që lidhen drejtpërdrejt me arritjen e objektivave mësimore. Mjetet bazike gjatë zhvillimit të lëndës të tilla si, tekste, stilolaps, fletore, vizore, ngjyra, ngjitës, laps etj nuk mungojnë për nxënësit.

b. Dobësitë

Mësimdhënësit nuk kanë bashkëpunim me prindërit dhe komunitetin për të siguruar mjete mësimore. Përgjithësisht prindërit ndodhen në pamundësi financiare për të dhënë kontributin e tyre në krijimin e mjeteve mësimore për zhvillimin e lëndëve. Në disa ofrues nuk ka mjaftueshëm mjete dhe vegla pune për detyra individuale ose në grupe gjatë praktikës profesionale. Pavarësisht se kjo dobësi nuk është evidentuar në një numër të madh ofruesish, është e rëndësishme që ofruesit të marrin masat e duhura për formimin praktik të nxënësve.

6. Mjedisi fizik

a. Rezultati

Mjedisi fizik i klasës dhe i zhvillimit të praktikave është i përshtatshëm dhe në funksion të metodave të përzgjedhura. Nxënësit dhe kursantët kanë mundësi të lëvizin dhe të komunikojnë lirshëm në klasë, duke mundësuar zhvillimin e punës në grupe të vogla. Hapësirat janë të mjaftueshme që nxënësit dhe kursantët të shpallin në vende të dukshme punime individuale, të ekipeve të vogla, të klasës apo mjedisit të praktikës, sipas kualifikimeve profesionale ose kurseve që zhvillohen.

b. Dobësitë

Nga analiza e raporteve të vetëvlerësimit si dhe të dhënat e gjeneruara nga scvet.al, nuk janë konstatuar mangësi për këtë nënfushë.

7. Metodologjia

a. Rezultati

Mësimdhënësit dhe instruktorët, në fund të orës mësimore, nxjerrin përfundimet dhe u japin “feedback” nxënësve dhe kursantëve. Detyrat që mësimdhënësit dhe instruktorët japin, synojnë nxitjen dhe përfshirjen aktive të nxënësve dhe kursantëve, në mënyrë të barabartë midis djemve dhe vajzave. Refleksionet, sqarimet, instruksionet jepen në momente të ndryshme të orës mësimore sipas nevojës. Nxënësit dhe kursantët punojnë në mënyrë individuale dhe në grupe në klasë ose në mjedisin e praktikës duke i realizuar detyrat brenda një kohe të përcaktuar.

Ora mësimore është e hapur për pjesëmarrjen e të interesuarve, si: kolegë, prindër, etj, pavarësisht se palët e ftuara nuk paraqiten gjithmonë. Prindërit, për arsye të ndryshme, nuk kanë përfshirje të gjerë në orët mësimore.

b. Dobësitë

Nuk janë evidentuar dobësi të theksuara për këtë nënfushë, nga ana e ofruesve të AFP-së.

8. Detyrat e shtëpisë

a. Rezultati

Shumica e mësimeve në shkollë u japin nxënësve detyra shtëpie. Ky kriter aplikohet më shumë në shkollë se sa në Qendrat e Formimit Profesional. Detyrat e shtëpisë, gjithashtu edhe projektet kurrikulare kanë, herë pas here, kërkesa për përdorimin e TIK-ut. Projektet kurrikulare mundësojnë edhe punën në grup midis nxënësve. Detyrat e shtëpisë nuk përmbajnë vetëm kërkesa për riprodhimin e njohurive të mësuara, por edhe zbatimin e tyre praktik në situata të jetës reale. Mësimeve i sqarojnë detyrat e shtëpisë në fund të orës së mësimit si dhe qortohen rregullisht detyrat e shtëpisë me shkrim duke bërë shënime në fletore ose me gojë.

b. Dobësitë

Nga analiza e raporteve të vetëvlerësimit dhe platformës *scvet.al* është arritur në përfundimin se detyrat e shtëpisë që japin mësimeve janë individuale dhe jo në grup për arsye të nxënësve janë në distanca të largëta nga njeri-tjetri. Ashtu si u përmend edhe në paragrafin e mësipërm, vetëm projektet e nxënësve realizohen në grupe pune. Në detyrat e shtëpisë nuk ka përfshirje të herëpashershme të situatave të të nxënësve që lidhen me edukimin dhe barazinë gjinore. Në provimet me shkrim nuk përdoret TIK-u, përveçse në kohën e pandemisë ku mësimi zhvillohej online. Nxënësve nuk u jepet mundësia të për zgjedhin vetë kërkesa për detyra shtëpie.

9. Përsëritja

a. Rezultati

Nga analiza e të dhënave të procesit të vetëvlerësimit për vitin shkollor 2022-2023, është evidentuar se drejtori i IoAFP-së zhvillon një provim vjetor me shkrim për disa lëndë dhe module. Mësimeve gjatë orëve të përsëritjes i angazhojnë nxënësve dhe kursantët të marrin pjesë aktivisht në mënyrë të pavarur, në detyra individuale dhe në grupe të vogla ose të përziera me djem dhe vajza, sipas rastit. Gjatë përsëritjes së një kapitulli, mësimeve gjithmonë synojnë të orientojnë nxënësve në zbulimin e lidhjeve të koncepteve të kapitullit/temës me ato të kapitujve/temave paraardhëse të lëndës së asaj klase.

b. Dobësitë

Nuk janë evidentuar problematika për këtë nënfushë.

10. Mjedis i sigurt për të nxënësve

a. Rezultati

Nga analiza e të dhënave të mbledhura nga vetëvlerësimi për të gjithë ofruesit u konstatua se mjediset fizike të klasave dhe të praktikave janë të përshtatshme për zhvillimin e orëve mësimore. Nxënësve kanë mundësi të lëvizim dhe të komunikojnë lirshëm në klasë, duke mundësuar zhvillimin e punës në ekipe të vogla. Ka mjaftueshëm hapësirë që nxënësve dhe kursantët të shpallin në vende të dukshme punime individuale, të ekipeve të vogla në klasa apo në mjediset e praktikave.

b. Dobësitë

Nuk janë konstatuar dobësi për këtë nënfushë.

Nxënësit dhe kursantët me nevoja të veçanta


a. Rezultati

Nga të dhënat e raportuara në platformën scvet.al dhe nga leximi i raporteve të vetëvlerësimit u arrit në konkluzionin se procesi mësimor në IoAFP mbështet nxënësit me nevoja të veçanta duke dhënë detyra klase dhe shtëpie të përshtatshme për ta. Mësimdhënësit bëjnë përpjekje për të përshtatur mësimin sipas niveleve të të nxënësve dhe kursantëve me nevoja të veçanta si dhe komentojnë dhe lavdërojnë për produktet dhe arritjet e këtyre nxënësve dhe kursantëve. Nxënësit dhe kursantët me nevoja të veçanta mbështeten edhe nga nxënësit dhe kursantët e tjerë në klasë.


b. Dobësitë

Disa pika të dobëta janë konstatuar në disa ofrues AFP-je. Materialet mësimore që janë përzgjedhur për nxënësit dhe kursantët me nevoja të veçanta jo gjithmonë dhe jo në të gjithë ofruesit e AFP-së janë të përshtatshme për ta. Jo në të gjithë ofruesit e AFP-së hartohen dhe zbatohen programe mësimore të personalizuara dhe “Planin e Edukimit Individual” (PEI) për nxënës dhe kursantë me aftësi të kufizuara dhe me nevoja tejet të veçanta. Por pavarësisht se kjo pikë e dobët nuk është e pranishme në të gjithë ofruesit, është e rëndësishme që të merren masat përkatëse nga të gjithë ofruesit duke kërkuar punësimin e një mësuesi ndihmës.

Në grafikun e mëposhtëm tregohet vlerësimi për secilin prej 39 ofruesve publikë të AFP-së për fushën 4 “Mësimdhënia dhe të nxënësve”.



Nga analiza e të dhënave sasiore për 39 ofruesit publikë të AFP-së për fushën 4 “Mësimdhënia dhe të nxënit”, është arritur në përfundimin se 13 ofrues e ka vlerësuar veten e tyre “Shumë mirë”, 26 prej tyre e kanë vlerësuar veten e tyre “Mirë”. Nuk ka asnjë ofrues AFP-je që ta ketë vlerësuar veten “Mjaftueshëm”, ose “Dobët”.



Grafiku i mëposhtëm tregon vlerësimin për secilën nënfushë të fushës 4, për të gjithë ofruesit publikë të AFP-së.



FUSHA 5 - VLERËSIMI

Ky proces përfshin vlerësimin periodik dhe përfundimtar të njohurive të nxënësve/kursantëve. Qëllimi kryesor i vlerësimit është të vlerësojë përparimin e nxënësve/kursantëve në programet e tyre dhe të ndihmojë në përmirësimin e procesit të nxënies. Vlerësimi është një proces që ka ndikim në motivimin e nxënësve dhe në vlerësimin e sukseseve të tyre përmes informacionit të dhënë nga mësuesi/instruktori, testet dhe portofoli i nxënësit.

Kjo fushë përbëhet nga gjashtë nënfusha të listuara si më poshtë:

1. Vlerësimi periodik i nxënësit/kursantit
2. Vlerësimi përfundimtar i nxënësit/kursantit
3. Procesi i vlerësimit
4. Arritjet
5. Rivlerësimi
6. Ankimimet

1. Vlerësimi periodik i nxënësit/kursantit

a. Rezultati

Vlerësimi periodik i nxënësit/kursantit është një proces standard, i kthyer në kulturë. Mësimdhënësit realizojnë vlerësimin nëpërmjet testeve/ detyrave përmbledhëse sipas udhëzimeve dhe i dokumentojnë ato.

b. Dobësitë

Nuk janë paraqitur problematika në zbatim të këtij procesi.

2. Vlerësimi përfundimtar i nxënësit/kursantit

a. Rezultati

Ofruesit realizojnë me korrektësi vlerësimin përfundimtar të nxënësve/kursantëve dhe Provimet Përfundimtare të Nivelit I, II dhe III në Arsimin Profesional. Për vlerësimin përfundimtar, IoAFP-të respektojnë peshën e përqindjeve zyrtare të vlerësimeve të vendosura për vlerësimin e vazhdueshëm, vlerësimin me test/detyrë përmbledhëse. Notat përfundimtare vjetore të nxënësve njehsohen bazuar në kriteret zyrtare. IoAFP-të zbatojnë me përpikëri procedurat e miratuara për organizimin dhe administrimin e provimeve përfundimtare pa pasur problematika evidente.

b. Dobësitë

Edhe në këtë vit vetëvlerësimi disa ofrues kanë pasur sfida përfshirjen e përfaqësuesve së bizneseve në komisionet e vlerësimit përfundimtar të praktikës profesionale.

3. Procesi i vlerësimit

a. Rezultati

Mësimdhënësit bazuar në procesin e vlerësimit kanë hartuar programet e tyre për vlerësimin e nxënësve, të cilat përfshijnë instrumente të ndryshme vlerësimi. Nëpërmjet këtyre metodave vlerësojnë ecurinë e nxënësve, përvetësimin e njohurive, evidentojnë mangësitë si dhe motivojnë dhe nxisin interesin e nxënësve.

b. Dobësitë

Sfidë që mbetet në këtë proces është përdorimi i teknikave që nxënësit/kursantët të vlerësojnë veten dhe njëri-tjetrin. Sikurse raportohet, këto teknika vazhdojnë të ngelen të pakonsoliduara mjaftueshëm në disa ofrues, ato përdoren rrallë herë ose nuk janë të dokumentuara.

4. Arritjet

a. Rezultati

Ofruesit e AFP-së realizojnë analiza të arritjeve të nxënësve/kursantëve në disa dimensione. Analizat përmbajnë të dhëna për rezultatet e Provimeve të Maturës Shtetërore dhe krahasohen me vlerësimin e brendshëm, po ashtu analizohen provimet e teorisë profesionale të integruar dhe rezultatet e kursantëve në provimet përkatëse të kurseve të unifikuara. Provimet përfundimtare realizohen me sukses konform kërkesave ligjore dhe udhëzimeve zyrtare nga institucionet përkatëse. Gjatë gjithë procesit mësimdhënësit mbajnë kontakt me prindërit duke i përditësuar rreth arritjeve të nxënësve.

b. Dobësitë

Disa ofrues raportojnë se nuk mund të analizojnë qartësinë dhe shkallën e të kuptuarit nga nxënësit të pyetjeve/kërkesave të testeve të Provimeve të Maturës Shtetërore pasi nuk kanë akses në teste. Gjithashtu vijon të ngelet pikë e dobët përfshirja e përfaqësuesve të biznesit në provimet përfundimtare të teorisë dhe praktikës profesionale të integruar dhe për pasojë ofruesit nuk mundën të krahasojnë përputhjen e këtyre rezultateve me vlerësimin e brendshëm.

5. Rivlerësimi

a. Rezultati

Në këtë nënfushë ofruesit kanë arritur të ngrenë dhe aplikojnë sipas rregullave mekanizmin e rivlerësimit.

b. Dobësitë

Nuk janë paraqitur problematika në zbatimin e këtij procesi.

6. Ankimimet


a. Rezultati

Tashmë procedurat e ankimimit të IoAFP-ve kanë marrë një formë të rregullt dhe përmbushin kërkesat ligjore.


b. Dobësitë

Nuk raportohen dobësi në këtë nënfushë.

Në formë grafike rezultati i fushës për ofruesit e AFP-së do të paraqitej si më poshtë.




Në formë grafike rezultati i nënfushave të Fushës 5 “Vlerësimi” paraqitet si më poshtë:




Nga analiza e raporteve të vetëvlerësimit të 39 Ofruesve të AFP-së për fushën “Vlerësimi”, ka rezultuar se 20 prej tyre e shohin vetën “Shumë mirë” në këtë fushë, 19 prej tyre e shohin veten “Mirë”, ndërkohë asnjë ofrues nuk e ka vlerësuar veten “Mjaftueshëm” ose “Dobët”.

Të dhënat janë paraqitur në figurën e mëposhtme:



Në grafikun e mëposhtëm paraqiten rezultatet në nivel kombëtar për secilën prej fushave të vetëvlerësimit, për të gjithë ofruesit publikë të AFP-së.



GJETJE TË EVIDENTURA NË RAPORTET E VETËVLERËSIMIT

Nga shqyrtimi i 39 raporteve të vetëvlerësimit të IoAFP-ve në nivel kombëtar dalin edhe këtë vit një sërë gjetjesh që do të vazhdojnë të merren në konsideratë në vitin në vijim gjatë procesit të vetëvlerësimit:

1. Marzh i ndryshëm vlerësimi (në vetëvlerësim)

IoAFP-të kanë lirinë e plotë të kryejnë vetëvlerësime për vetë institucionin e tyre si dhe të aktorëve që bashkëpunojnë. Në fund të vlerësimit ofruesit hartojnë raportin ku tregohet niveli i cilësisë, arritjet, sfidat etj.

Vetëvlerësim i ndryshëm i ofruesve sjell një pabarazi dhe një perceptim shumë të ndryshëm dhe jo real. Nëse krahasojmë të njëjtën fushë nga një IoAFP në një tjetër vërehet se marzhi i vlerësimit është i ndryshëm dhe që realisht nuk përputhet me kapacitetin e vetë IoAFP-ve. Mekanizma rregullues duhet të shtohen në fund ose përgjatë procesit të vlerësimit për të evituar vlerësimet jo reale, siç mund të jenë mbivlerësimet apo nënvlerësimet.

2. Cilësia e shkrimit të raportit

Cilësia e shkrimit të raporteve mbetet një pikë e dobët e IoAFP-ve. Drejtoritë e shkollave në bashkëpunim me NJZH duhet të përzgjedhin personel dhe t'i trajnojnë për shkrimin e raportit të vetëvlerësimit me një cilësi më të lartë.

3. Përdorimi me efikasitet i instrumenteve të ndryshme analitike (analizën SWOT)

Kategorizimi i gjetjeve shpesh nuk është i qartë dhe nuk ka një klasifikim të duhur në analiza SWOT, tek të gjithë ofruesit. Shpesh IoAFP-të nuk klasifikojnë si duhet pikat e forta, pikat e dobëta, shanset, kërcënimet; definicionet e tyre janë jo të qarta.

4. Mangësi në plotësimin e platformës *scvet.al*

Sërish IoAFP-të shfaqin të meta në lidhje me plotësimin e platformës *scvet.al*. IoAFP-të nuk sinkronizojnë apo plotësojnë platformën apo në disa raste janë kontradiktore thëniet e tyre. Ka mangësi të natyrës, ku argumentet nuk përputhem me evidencat. Vihet re që nuk listohen gjithmonë evidencat mbështetëse.

5. Shkrimi zyrtar

Përgjatë shkrimit të raportit apo edhe të dokumentave të tjera që ofruesit hartojnë shihet që ka mangësi edhe në nivel të përdorimit të shkrimit zyrtar, aq më shumë kur institucionet janë ofrues të arsimit. Nuk përdoret germat “ë”, “Ë”, “ç”, “Ç”.

REKOMANDIME

FUSHA 1

Nënfusha 1

1. Të merren masa për përfshirjen më aktive të prindërve në Këshillin e Prindërve sipas një plani pune dhe me takime periodike.

Nënfusha 2

2. Të krijohen ekipet mbikëqyrëse për vëzhgimin dhe zbatimin e planit afatmesëm duke dokumentuar punën.

Nënfusha 3

3. Të hartohen objektiva që pasqyrojnë veprimtari me aspekte gjinore në planin vjetor.

Nënfusha 4

4. Të hartohet një plan për zhvillimin e minitesteve në mënyrë periodike për të gjitha kualifikimet profesionale.
5. Të krijohet një format dhe raport standard për vëzhgimin e orëve mësimore i cili përfshin aspekte gjinore dhe dokumenton analizën e gjetjeve të orëve të vëzhguara.

Nënfusha 5

6. Të merren masa për bërjen e librit të inventarit si dokument transparent për IoAFP dhe komunitetin.

Nënfusha 7

7. Të realizohet vetëvlerësimi nëpërmjet një instrumenti standard për mësimdhënësit dhe ekipeve të drejtimit profesional.
8. Të mirëmbahen apo krijohen faqet e internetit të ofruesve për publikimin e raportit përfundimtar të vetëvlerësimit.

Nënfusha 8

9. Të hartohen plane pune për shkëmbimet e përvojave profesionale të mësuesve midis dhe brenda departamenteve, por dhe nëpërmjet rrjeteve profesionale të takimeve të drejtpërdrejta dhe atyre online.

Nënfusha 9

10. Të merren masa për të nxitur pjesëmarrjen e të gjithë mësimdhënësve në veprimtari të ndërkurrikulare që organizojnë ekipet ku përfshihen apo institucioni në tërësi.
11. Të ekspozohen në mjedise të dukshme për grupet e interesit shpenzimet financiare të ofruesve.

FUSHA 2

Nënfusha 1

12. Të intensifikohen marrëdhëniet me qeverinë vendore për mundësimin e kryerjes së praktikave profesionale pranë tyre.
13. Të planifikohen dhe zbatohen veprimtari me aspekte gjinore në bashkëpunim me institucionet vendore.

Nënfusha 2

14. Të zhvillohet analiza periodike e tregut për zonën ku IoAFP-të zhvillojnë veprimtarinë, e detajuar dhe për të gjitha kualifikimet profesionale.
15. Të planifikohen dhe zbatohen veprimtari me aspekte gjinore në bashkëpunim me biznesin.
16. Të identifikohen nga NJZH punonjës të kualifikuar në biznese për të zhvilluar tema të ndryshme në shkollë.

Nënfusha 3

17. Të merren masa për pjesëmarrjen aktive të prindërve në vlerësimin e brendshëm, hartimin e planeve, pjesëmarrjen në aktivitete ekstrakurrikulare etj.
18. Të realizohen studime dhe analiza e nevojave të tregut të punës në bashkëpunim me komunitetin.
19. Të mirëmbahen baza e të dhënave të OJF-ve për të mbajtur komunikim me to.
20. Të rritet kapaciteti i burimeve njerëzore për hartimin e projekteve zhvillimore për të siguruar mbështetje nga OJF-të.
21. Të planifikohen dhe zbatohen veprimtari me aspekte gjinore në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe OJF-të.

Nënfusha 4

22. Të krijohen binjakëzime me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit.
23. Të krijohen marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet e Arsimit të Lartë dhe arsimit post sekondar me qëllim përgatitjen profesionale të nxënësve/kursantëve, trajnimin e stafit dhe përmirësimin dhe rifreskimin e kurrikulës së përgatitjes profesionale dhe hartimin e materialeve mbështetëse.

FUSHA 3

Nënfusha 3

24. Të nxitet bashkëpunimi me prindërit për tematikat dhe realizimin e projekteve kurrikulare.
25. Të trajtohen çështje të barazisë gjinore në detyrat që u jepen nxënësve.
26. Të kërkohet hartimi i raporteve përfundimtare të projekteve të nxënësve duke përfshirë të gjithë elementët e kërkuar.

Nënfusha 4

27. Të bëhen përpjekje për të nxitur bashkëpunimin e prindërve me ofruesit në krijimin e mjeteve mësimore për nxënësit.
28. Të bëhen përpjekje për sigurimin e teksteve profesionale në ofrues.

Nënfusha 5

29. Të nxitet përfshirja e anëtarëve të Bordit të shkollës dhe të prindërve në mbledhjet e departamenteve.

FUSHA 4

Nënfusha 1

30. Rekomandohet që mesimdhënësit të përcaktojnë në planet ditore:
- të dhëna mbi mangësitë e nxënësve dhe kursantëve me vështirësi në të nxënë.
 - rezultate të lidhura ngushtë me njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që synohen në fund të orës mësimore, të cilat përfshijnë dhe edukimin e barazisë gjinore.

Nënfusha 5

31. Të nxitet bashkëpunimi me prindërit dhe komunitetin në krijimin e mjeteve mësimore.
32. Të merren masa për shtimin e bazës materiale (mjetet dhe veglat e punës) për kualifikimet profesionale që ofrohen.

Nënfusha 8

33. Të përfshihen në detyrat e shtëpisë situata të të nxënësve që lidhen me edukimin dhe barazinë gjinore.
34. Të përdoret TIK-u në provimet me shkrim.
35. T'u jepet mundësia nxënësve të përzgjedhin vetë kërkesa për detyra shtëpie.

Nënfusha 11

36. Të përzgjidhen materiale mësimore të përshtatshme për nxënësit me nevoja të veçanta, të përshtatura me llojin e aftësisë së kufizuar.
37. Të bëhet kërkesë në institucionet përgjegjëse për punësimin e një mësuesi ndihmës, në ofruesit që kanë nxënës me nevoja të veçanta.
38. Të hartohen planet PEI për nxënësit me nevoja të veçanta në bashkëpunim me mësuesit ndihmës dhe psikologun e shkollës (nëse ka).

FUSHA 5

Nënfusha 2

39. Të informohen përfaqësuesit e biznesit për rëndësinë e pjesëmarrjes në komisionet e vlerësimit përfundimtar të praktikës profesionale.

Nënfusha 3

40. Të konsolidohen dhe dokumentohen teknika e “vetëvlerësimit të nxënësit/kursantit” si dhe “vlerësimi për njëri-tjetrin”.

Nënfusha 4

41. Të kryhet analiza e testimeve të Provimeve të Maturës Shtetërore në përputhje me programet e lëndëve përkatëse.